

LIGJ
Nr. 8/2023

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PËRMBARIMOR
GJYQËSOR SHTETËROR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, kushtet që duhet të përmbushin shtetasit për të ushtruar detyrën e përmbaruesit gjyqësor shtetëror, statusin, vlerësimin etik dhe profesional të tyre, procedimin disiplinor, përfundimin e marrëdhënies në shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror, si dhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë, që kryejnë veprimtarinë përmbarimore për ekzekutimin e titujve ekzekutivë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, Kodin Civil dhe aktet e tjera ligjore, si dhe për subjektet e tjera publike dhe private, që përfshihen në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm.

2. Ky ligj zbatohet edhe për veprimtaritë dytësore që kryen përmbaruesi gjyqësor shtetëror, si:

- kryerja e njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare;
- njoftimi dhe mbledhja e detyrimeve financiare me mirëkuptim, me kërkesë të të interesuarve;
- kryerja e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi, me kërkesë të të interesuarve;
- shitja e sendeve në ankand publik, me kërkesë të të interesuarve.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- “Përmbaruesi gjyqësor shtetëror” është shtetasi i emëruar nga ministri i Drejtësisë për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë dhe veprimtarive dytësore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- “Ministri” është ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë;
- “Ministria” është ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë;
- “Veprimtari dytësore” është veprimtaria që kryhet nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- “Kryetari i zyrës përmbarimore” është përmbaruesi gjyqësor shtetëror që ushtron edhe funksionin e drejtimit administrativ të zyrës përmbarimore vendore;

dh) “Komandimi” është caktimi i përkohshëm i përmbaruesit gjyqësor shtetëror të zyrës përmbarimore vendore në pozicionin e inspektorit në strukturën përgjegjëse për inspektimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji;

e) “Transferimi” është lëvizja e përkohshme ose e përhershme e përmbaruesit gjyqësor shtetëror nga zyra përmbarimore në të cilën është emëruar në një zyrë tjetër përmbarimore në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 4

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor

Shërbimi Përmbarimor në Republikën e Shqipërisë organizohet në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, sipas këtij ligji, dhe në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor të organizuar mbi baza private, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor privat.

Neni 5

Parimet bazë të veprimtarisë përmbarimore

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror gjatë ushtrimit të profesionit udhëhiqet nga parimet bazë të ligjshmërisë, ndershmërisë, paanësisë, profesionalizmit, etikës dhe respektimit të të drejtave dhe interesave të palëve në procesin e ekzekutimit.

2. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror në ushtrimin e veprimtarisë përmbarimore përfaqëson autoritetin shtetëror.

3. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror në ushtrimin e detyrave të tij i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të këtij ligji, Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil dhe akteve të tjera për ekzekutimin e titujve ekzekutivë dhe kryerjen e veprimtarive dytësore.

KREU II

SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR

Neni 6

Organizimi i Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror

1. Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror varet nga ministri dhe organizohet në nivel qendror dhe vendor, si vijon:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, e cila përbën nivelin qendror të organizimit;

b) zyrat përmbarimore vendore, të cilat përbëjnë nivelin vendor të organizimit dhe varen administrativisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit.

2. Rregulla të hollësishme lidhur me metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe zyrave përmbarimore vendore përcaktohen në rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, e cila miratohet me urdhër të ministrit.

Neni 7

Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit

1. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit përgjigjet për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit.

3. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, me diplomë “Master i shkencave” ose “Master profesional”, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje

normale 2 vite akademike apo të barasvlershme me to, ose të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

c) të ketë jo më pak se 7 (shtatë) vjet përvojë profesionale si jurist;

ç) të mos jetë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

d) të ketë integritet të lartë moral;

dh) të plotësojë kriteret për të mos iu nënshtruar ndalimeve për t'u emëruar në një funksion publik sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

e) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

ë) të mos jetë dënuar me vendim penal të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje.

4. Funksioni i drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër shtetëror, me anëtarësimin në partitë politike dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë e tyre, si dhe me çdo veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies.

Neni 8

Përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit

Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit ka këto përgjegjësi:

a) drejton, bashkërendon dhe kontrollon veprimtarinë e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror;

b) siguron unifikimin e kuptimit dhe zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe të praktikave në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit;

c) përgatit dhe nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshme me natyrë administrative ose procedurale, si dhe metodika për mbarëvajtjen dhe metodën e punës, trajtimin në përgjithësi të çështjeve në ekzekutim për garantimin e kuptimit dhe zbatimit uniform të ligjit dhe praktikave në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit;

ç) i propozon ministrit emërimin dhe shkarkimin e kryetarëve të zyrave përmbarrimore;

d) emëron, liron dhe shkarkon punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe të zyrave përmbarrimore vendore;

dh) kontrollon dokumentimin e veprimtarisë përmbarrimore;

e) organizon dhe kujdeset për trajnimin e përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë;

ë) ndjek zbatimin e etikës profesionale gjatë veprimtarisë përmbarrimore;

f) përfaqëson Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror në marrëdhënie me të tretët;

g) mban dhe zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shtetërore apo private për realizimin e veprimtarisë përmbarrimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

gj) promovon Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror dhe veprimtarinë që kryhet prej tij, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë përmbarrimore dhe rritjen e besimit të publikut ndaj këtij shërbimi;

h) ushtron përgjegjësi të tjera të përcaktuara me ligj ose me akte nënligjore.

Neni 9

Organizimi i zyrave përmbarrimore vendore

1. Zyrat përmbarrimore vendore përbëhen nga:

a) kryetari i zyrës përmbarrimore;

b) përmbarruesit gjyqësorë shtetërorë;

c) personeli administrativ dhe teknik.

2. Çdo zyrë përmbarrimore vendore është person juridik dhe ka vulën e saj.

3. Marrëdhëniet e punës të personelit administrativ dhe teknik rregullohen nga Kodi i Punës.

Neni 10

Kryetari i zyrës përmbarimore

1. Kryetar i zyrës përmbarimore zgjidhet përmbaruesi gjyqësor shtetëror, që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, me diplomë “Master i shkencave” ose “Master profesional”, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike apo të barasvlershme me to, ose të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

b) të ketë të paktën pesë vjet përvojë pune si përmbarues gjyqësor shtetëror;

c) të mos ketë masë disiplinore në fuqi dhe ndaj tij të mos ketë filluar procedimi disiplinor;

ç) të jetë vlerësuar “shkëlqyeshëm” në dy vlerësimet e fundit etike dhe profesionale, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

d) të ketë aftësi organizative dhe drejtuese;

dh) të ketë aftësi komunikimi;

e) të ketë integritet të lartë moral dhe profesional.

2. Kryetari i zyrës përmbarimore emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga ministri, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit. Në rast mungese, paaftësie afatshkurtër për ushtrimin e detyrave ose vakance, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit cakton përkohësisht një prej përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë që ka vjetërsi më të madhe pune në shërbimin përmbarimor gjyqësor për kryerjen e detyrave të kryetarit të zyrës përmbarimore.

3. Në rast se pas shqyrtimit të dokumentacionit justifikues për përmbushjen e kriterëve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, rezulton më shumë se një kandidat potencial që plotëson këto kriterë, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit i propozon ministrit kandidatin që ka më shumë vjetërsi pune si përmbarues gjyqësor shtetëror.

Neni 11

Organika

1. Numri i përgjithshëm i përmbaruesve gjyqësorë të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror caktohet me urdhër të ministrit, pasi të ketë marrë mendimin me shkrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

2. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, si dhe e zyrave përmbarimore vendore miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore duke mbajtur në konsideratë, por pa u kufizuar, organizimin e rretheve gjyqësore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 12

Këshilli i Përmbarimit

1. Këshilli i Përmbarimit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:

a) Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë;

b) drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit;

c) një këshilltar i ministrit;

ç) drejtori i përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë që mbikëqyr veprimtarinë e përmbarimit shtetëror;

d) një anëtar që zgjidhet nga drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit nga radhët e përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë.

2. Kandidati i zgjedhur sipas pikës 1, shkronja “d”, të këtij neni duhet të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë profesionale si përmbarues gjyqësor. Zgjedhja e këtij anëtari bëhet përmes shortit dhe duhet të synojë shmangien e konfliktit të interesit.

3. Këshilli i Përmbarimit mbështetet administrativisht nga Ministria e Drejtësisë.

4. Rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Përmbartimit përcaktohen me urdhër të ministrit.

5. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Përmbartimit caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas rregullave të përcaktuara për shpërblimin e anëtarëve të organeve kolegjiale.

Neni 13

Burimet financiare

1. Për realizimin e detyrave, Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror ka buxhetin e vet, si pjesë e veçantë brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror ka të drejtë të përdorë të ardhura të tjera të krijuara nga veprimtaria përmbartimore, që lejohen me ligj.

Neni 14

Sigurimi i të ardhurave nga veprimtaria përmbartimore

1. Çdo veprim përmbartimor kryhet kundrejt pagimit të tarifave përkatëse, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Ndarja e të ardhurave, kriteret e procedurat e administrimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat.

KREU III

EMËRIMI I PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Neni 15

Organi emërues

1. Ministri është autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili emëron përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë për ushtrimin e veprimtarisë përmbartimore në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj.

2. Asnjë shtetas nuk mund të ushtrojë funksionin e përmbartuesit gjyqësor shtetëror pa u pajisur më parë me aktin e emërimit si përmbartues gjyqësor shtetëror, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 16

Kushtet për emërimin e përmbartuesit gjyqësor shtetëror

Shtetasi, që kërkon të emërohet si përmbartues gjyqësor shtetëror, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- c) të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit ose diplomë të njësuar me të, ose të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;
- ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë;
- d) të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë;
- dh) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- e) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë profesionale si jurist;
- ë) të ketë integritet moral të lartë;
- f) të ketë kaluar me sukses provimin e pranimit për përmbartues gjyqësor shtetëror.

Neni 17

Pranimi në Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror

1. Pranimi në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror bëhet nëpërmjet konkursit të hapur, i cili organizohet nga Këshilli i Përmbarimit.

2. Procesi i përzgjedhjes përfshin provimin e pranimi, që planifikohet për zhvillim bazuar mbi kërkesat dhe nevojat publike për numrin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 11 të këtij ligji.

3. Të gjithë individët që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 16 të këtij ligji, kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit të pranimi për përmbarues gjyqësor shtetëror.

4. Provimi i pranimi përbëhet nga pjesa e kontrollit të njohurive me shkrim dhe pjesa e provimit me gojë, ku pjesa e provimit me shkrim përmban 75% të numrit total të pikëve.

5. Rregulla të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimi, si dhe procedurën e vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve përcaktohen me urdhër të ministrit.

Neni 18

Periudha e provës

1. Kandidatët fitues i nënshtrohen një periudhe prove që zgjat 6 (gjashtë) muaj nga data e aktit të emërimit të ministrit.

2. Gjatë periudhës së provës, përmbaruesi gjyqësor shtetëror kryen detyrat nën kujdesin e një përmbaruesi të vjetër në detyrë dhe i nënshtrohet trajnimit të detyrueshëm.

3. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror gjatë periudhës së provës gëzon të drejtat dhe detyrimet e përmbaruesit gjyqësor shtetëror, të përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera.

4. Në fund të periudhës së provës, ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit, vendos:

a) emërimin përfundimtar si përmbarues gjyqësor; ose

b) largimin nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.

5. Vendimarrja, sipas pikës 4 të këtij neni, bazohet në çdo rast në vlerësimin e rezultateve në punë nga përmbaruesi gjyqësor mbikëqyrës dhe në rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të trajnimit.

Neni 19

Programi i detyrueshëm i trajnimit

1. Programi i detyrueshëm i trajnimit për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove zhvillohet për një kohëzgjatje prej jo më pak se 200 orësh në 6 muaj dhe ka si qëllim aftësimin e tyre me njohuritë e duhura profesionale për ushtrimin e veprimtarisë përmbarimore.

2. Programi i detyrueshëm i trajnimit realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ose nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike apo nga institucione të arsimit të lartë të akredituara sipas ligjit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucione të interesuara apo me organet drejtuese të dhomave të profesioneve të lira për organizimin e programeve të përbashkëta të trajnimeve ose për trajnime specifike.

4. Organizimi dhe përmbajtja e programit të trajnimit, rregullat për pjesëmarrjen në trajnime, si dhe për testimin e njohurive të përfituara përcaktohen me urdhër të ministrit.

KREU IV

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRMBARUESVE GJYQËSORË SHTETËRORË

Neni 20

Të drejtat e përmbaruesit gjyqësor shtetëror

Përmbaruesi gjyqësor shtetëror ka të drejtat e mëposhtme:

a) të marrë lirisht masat për ekzekutimin e çështjeve apo kryerjen e veprimtarive dytësore të ngarkuara në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera ligjore, me përjashtim të rastit kur konstaton se është në situatën e konfliktit të interesit;

- b) të kërkojë, kur e konsideron të nevojshme për veprimtarinë e tij procedurale, çdo informacion që ka të bëjë me gjendjen pasurore të debitorit apo vendndodhjen e tij, të nevojshëm për procedurat e ekzekutimit, nga institucione shtetërore, persona juridikë apo fizikë, në përputhje me ligjin;
- c) të kërkojë mbështetjen dhe ndihmën e institucioneve shtetërore dhe subjekteve të tjera, kur e çmon të domosdoshme, gjatë procedurave të ekzekutimit;
- ç) t'i sigurohet mbrojtja e integritetit fizik, moral dhe dinjitetit;
- d) të përfitojë pagë dhe përfitime të tjera sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- dh) të anëtarësohet në sindikata apo shoqata profesionale;
- e) të përmirësojë aftësitë profesionale nëpërmjet programit të formimit vazhdues;
- ë) të përfitojë trajtim shëndetësor dhe sigurime shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- f) çdo të drejtë tjetër që i garantohet nga ky ligj dhe akte të tjera në fuqi.

Neni 21

Detyrat e përmbauesit gjyqësor shtetëror

Përmbauesi gjyqësor shtetëror ka këto detyra:

- a) të veprorë me ndershmëri, paanësi, profesionalizëm dhe kurdoherë në interes të palës kreditore, pa cenuar në mënyrë të paligjshme të drejtat dhe interesat e palës tjetër;
- b) të zbatojë me përpikëri dispozitat e këtij ligji, Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, që lidhen me veprimtarinë përmbaimore, si dhe urdhrat, udhëzimet e metodikat e drejtorit të përgjithshëm të Përmbaimit;
- c) të kryejë për subjektet fizike ose juridike veprimet e nevojshme, që synojnë realizimin e së drejtës së tyre dhe mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshëm;
- ç) të informojë për çdo veprim procedural palët në proces ekzekutimi, si dhe të japë sqarimet e nevojshme për veprimet e kryera;
- d) të këshillojë palën kreditore për pasojat juridike që rrjedhin nga veprimet procedurale, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre;
- dh) të ruajë sekretin profesional dhe të mos zbulojë të dhëna që i ka mësuar gjatë veprimtarisë së tij profesionale ose nga dokumentet, që i janë vënë në dispozicion nga palët në proces ekzekutimi, përveç kur dhënia e këtij informacioni është detyrim ligjor;
- e) të marrë çdo masë të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe praktikën gjyqësore mbi veprimtarinë përmbaimore;
- ë) të ndjekë trajnimet e programit të formimit vazhdues për përmirësimin e aftësive profesionale;
- f) të marrë masat dhe veprimet e nevojshme për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, në respekt të dinjitetit njerëzor, duke vënë në balancë nevojat e debitorëve dhe interesat e kreditorëve;
- g) të respektojë dhe të zbatojë rregullat e etikës dhe standardet profesionale në ushtrimin e detyrës, duke garantuar ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te shërbimi përmbaimit gjyqësor shtetëror;
- gj) të mbajë të ekspozuar në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit si përmbaues gjyqësor shtetëror kur kryen veprime procedurale përmbaimore, si dhe kur paraqitet përpara palëve të interesuara në lidhje me një procedurë përmbaimore.

Neni 22

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

1. Përmbauesit gjyqësorë shtetërorë ndjekin programin e formimit vazhdues, i cili ka për qëllim përditësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave të tyre.
2. Programi i formimit vazhdues përcakton objektivat, modulet e trajnimit, organizimin e trajnimeve dhe kohëzgjatjen e tyre, rregullat e frekuentimit, mënyrën e kontrollit të njohurive dhe aftësive, si dhe rregulla të tjera të hollësishme për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të përmbauesve gjyqësorë shtetërorë.
3. Programi i formimit vazhdues miratohet me urdhër të ministrit.

Neni 23

Papajtueshmëritë me funksionin e përmbauesit gjyqësor shtetëror

1. Përmbauesi gjyqësor shtetëror nuk mund të ushtrojë njëkohësisht funksione apo veprimtari publike dhe të kryejë veprimtari që vijnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose janë të papajtueshme me ushtrimin e detyrës së përmbauesit gjyqësor shtetëror.

2. Përmbauesi gjyqësor shtetëror nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër politike, shtetërore ose profesionale, që realizohet kundrejt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë akademike ose shkencore.

3. Funksioni i përmbauesit gjyqësor shtetëror është i papajtueshëm me:

a) anëtarësinë në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike;

b) kryerjen e çdo veprimtarie politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim ose jo me ndonjë parti politike.

Neni 24

Konflikti i interesit

1. Përmbauesi gjyqësor shtetëror është i detyruar të mos pranojë ekzekutimin e çështjes ose të heqë dorë nga ekzekutimi, nëse ka filluar, nëse ai ka marrë dijeni ose duhet të kishte marrë dijeni për ekzistencën e një shkak, që tregon një konflikt interesi, kur:

a) ka një interes në çështjen përkatëse ose në një çështje tjetër, që ka lidhje me atë në ekzekutim;

b) ai vetë ose bashkëshortja e tij është e afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët në proces ekzekutimi ose me përfaqësuesit;

c) ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor a në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve në proces ekzekutimi ose njërin prej përfaqësuesve;

ç) është kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër, që ka interesa për çështjen në ekzekutim;

d) në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

2. Mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga ekzekutimi i çështjes nga përmbauesi gjyqësor, i cili ka dijeni ose duhet të kishte marrë dijeni për ekzistencën e konfliktit të interesit, konsiderohet shkelje disiplinore.

Neni 25

Heqja dorë nga ekzekutimi

1. Përmbauesi gjyqësor shtetëror, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka arsye për të mos marrë pjesë në ekzekutimin e një çështjeje për shkak të konfliktit të interesit, i paraqet menjëherë kërkesën për heqje dorë nga ekzekutimi i çështjes kryetarit të zyrës përmbaimore.

2. Kryetari i zyrës përmbaimore, kur e vlerëson me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një tjetër përmbaues gjyqësor të asaj zyre përmbaimore brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës. Për kryetarin e zyrës përmbaimore, zëvendësimi urdhërohet nga drejtori i përgjithshëm i Përmbaimit.

3. Përmbajtja e kërkesës për heqje dorë nga ekzekutimi i çështjes dhe vendimi u njoftohet palëve në proces ekzekutimi.

Neni 26

Praktika të ndaluara

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, përmbauesi gjyqësor shtetëror nuk duhet të kryejë veprime që cenojnë subjektet, që u nënshtrohen procedurave të ekzekutimit.

2. Ndalohet veçanërisht kryerja e veprimtarive të mëposhtme:

a) përdorimi i paligjshëm i forcës ndaj subjekteve fizike, që i nënshtrohen ekzekutimit të detyruar apo pasurisë së tyre;

- b) kërcënimi fizik apo presioni psikologjik ndaj subjektit, palë në procedurë ekzekutimi;
- c) përdorimi i fjalëve të pahijshme, që cenojnë reputacionin apo dinjitetin e subjekteve, që i nënshtrohen ekzekutimit të detyruar;
- ç) angazhimi në ndonjë praktikë të ndaluar ose përdorimi i ndonjë metode të pandershme në mbledhjen e detyrimeve, në kundërshtim me dispozitat ligjore;
- d) çdo veprim tjetër me karakter mashtrues, i cili do të komprometonte rëndë besimin e palëve dhe integritetin moral të përmbaruesit gjyqësor;
- dh) angazhimi i personave të tjerë të paemëruar për ushtrimin e veprimtarisë përmbarimore.

Neni 27

Konfidencialiteti

Përmbaruesi gjyqësor shtetëror, i cili merr informacione gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ruan konfidencialitetin e këtyre të dhënave dhe nuk duhet t'ua japë këto informacione të tretëve, përveç:

- a) organeve të rendit publik, prokurorisë ose gjykatës;
- b) Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, vetëm për efekt të ushtrimit të kompetencave, sipas këtij ligji;
- c) strukturave të tjera shtetërore lidhur me çështjet pasurore të debitorëve;
- ç) përmbaruesve të tjerë vetëm nëse informacioni është i nevojshëm për procedurat e ekzekutimit;
- d) kreditorit, i cili ka depozituar për ekzekutim një titull ekzekutiv në rastet kur nuk është njohur rregullisht me këtë informacion;
- dh) kur personi për të cilin kërkohet informacioni jep pëlqimin.

Neni 28

Dokumenti i identifikimit

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror ka dokument identifikues si përmbarues gjyqësor shtetëror, të cilin e paraqet në çdo rast të ushtrimit të detyrës.
2. Dokumenti përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.
3. Dokumenti i identifikimit përmban:
 - a) emrin, mbiemrin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror;
 - b) stemën e Republikës së Shqipërisë dhe logon e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit;
 - c) zyrën përmbarimore vendore ku do të ushtrojë veprimtarinë përmbaruesi gjyqësor shtetëror.
4. Forma e dokumentit të identifikimit përcaktohet me urdhër të ministrit.

Neni 29

Mbrojtja e veçantë e përmbaruesit gjyqësor shtetëror

1. Kur përmbaruesit gjyqësor shtetëror gjatë ushtrimit të detyrës së tij ose për shkak të saj i rrezikohet jeta, shëndeti, familja apo prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë.
2. Kushtet dhe mënyra e përfitimit të kësaj mbrojtjeje përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30

Dorëzimi i dokumentacionit pas largimit nga detyra

1. Kur përmbaruesi gjyqësor shtetëror largohet nga detyra sipas rasteve të parashikuara në këtë ligj dhe ka në proces ekzekutimi çështje përmbarimore të papërfunduara, kryetari i zyrës përmbarimore cakton përmbaruesin gjyqësor shtetëror zëvendësues.
2. Rregulla të hollësishme për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU V

TRAJTIMI FINANCIAR I PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Neni 31

Paga e përmbaruesit gjyqësor shtetëror

1. Paga e përmbaruesit gjyqësor shtetëror duhet të jetë në përputhje me natyrën e përgjegjësisë së detyrës së përmbaruesit dhe e përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tyre.

2. Paga e përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në çdo rast, paga e përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë nuk mund të jetë më e ulët se paga mujore e drejtorit të drejtorisë në ministri.

3. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror, në varësi të rezultateve në punë, mund të përfitojë një shpërblim, i cili përballohet nga të ardhurat që i mbeten Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji. Shpërblimi i posaçëm caktohet në çdo rast me urdhër të ministrit.

Neni 32

Përfitime të tjera

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguar prej 4 (katër) javësh kalendarike. Si rregull, pushimi vjetor përfshin një periudhë prej tre javësh, pa ndërprerje në muajt korrik dhe gusht. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror, i ngarkuar me detyra të ngutshme në këtë periudhë, pushimin vjetor e kryen në një periudhë tjetër, duke përfituar 5 (pesë) ditë pushimi shtesë.

2. Pushimi vjetor jepet nga kryetari i zyrës përmbarimore.

3. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror ka të drejtë që në raste të veçanta, për nevoja personale ose familjare, të kërkojë leje pa të drejtë page. Kohëzgjatja e kësaj leje përcaktohet nga kryetari i zyrës përmbarimore. Kohëzgjatja maksimale e lejeve të papaguara brenda një viti kalendarik nuk mund të jetë më e gjatë se 30 ditë.

4. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të kërkojë leje të papaguar deri në 2 (dy) vjet për arsye shëndetësore, familjare ose për qëllime kualifikimi apo specializimi profesional. Leja e papaguar mund të merret e gjitha njëherësh ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së përmbaruesit.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit mund të japë lejen e papaguar sipas pikës 4, pasi ka marrë mendimin e kryetarit të zyrës përmbarimore, nëse leja nuk cenon interesat e funksionit dhe nuk vë në rrezik në tërësi përmbarimin e funksionit me eficiencë dhe në kohë në zyrën përmbarimore. Periudha e lejes së papaguar nuk merret në konsideratë për vjetërsinë në punë ose për efekt të përfitimeve të tjera.

6. Ministri miraton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar, sipas këtij neni.

Neni 33

Koha e punës

1. Kohëzgjatja javore e punës dhe orari, si rregull, janë të njëjta me ato të institucioneve të administratës shtetërore.

2. Për nevoja pune, me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me urdhër të kryetarit të zyrës përmbarimore përkatëse, përmbaruesi gjyqësor shtetëror është i detyruar të punojë edhe jashtë orarit të punës në ditët e pushimit ose në ditët e festave zyrtare, brenda kufijve të përcaktuar në Kodin e Punës. Në këto raste zbatohen rregullat për kompensimin e orëve shtesë, sipas legjislacionit në fuqi për orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore.

KREU VI TARIFAT

Neni 34

Tarifat fikse të veprimeve përmbarimore

1. Për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve procedurale nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, paguhet tarifa fikse.

2. Masa e tarifës fikse caktohet duke mbajtur në konsideratë vlerën dhe llojin e detyrimit, si dhe kompleksitetin e veprimit procedural përmbartimor.

3. Masa e tarifës fikse të veprimit përmbartimor, llojet e veprimeve përmbartimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat.

Neni 35

Tarifa e suksesit

1. Përmbartuesi gjyqësor shtetëror përfiton një tarifë suksesi, e cila mund të jetë në formën e një shume të caktuar, një përqindje e caktuar mbi vlerën e detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar apo nëpërmjet kombinimit të të dyjave mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Masa e tarifës së suksesit caktohet në marrëveshjen mes kreditorit dhe përmbartuesit gjyqësor shtetëror.

2. Ministri dhe ministri përgjegjës për financat përcaktojnë me udhëzim të përbashkët nivelin minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbartimore. Tarifa e suksesit nuk parapaguhet dhe nuk i ngarkohet debitorit.

3. Marrëveshja tip për mbledhjen e tarifës së suksesit nga Shërbimi Përmbartimor Shtetëror miratohet me urdhër të ministrit.

Neni 36

Tarifat e veprimtarive dytësore

Tarifat për veprimtaritë dytësore të përmbartuesit gjyqësor shtetëror, të parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 37

Rastet e pakthyeshmërisë së tarifës

1. Në rastet e ekzekutimeve të pasuksesshme, kur nga përmbartuesi gjyqësor shtetëror janë kryer në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme të gjitha veprimet procedurale, tarifat fikse janë të pakthyeshme.

2. Kur pala kreditore ka paguar tarifën fikse të fillimit të procedurës përmbartimore dhe detyrimi përmbushet në mënyrë vullnetare nga pala debitore brenda afateve ligjore, tarifa fikse e fillimit të procedurës është e pakthyeshme.

KREU VII

MARRËDHËNIET ME PALËT NË PROCES EKZEKUTIMI DHE ME TË TRETËT

Neni 38

Marrëdhëniet me palën kreditore

Pala kreditore ka të drejtë të kërkojë nga përmbartuesi gjyqësor shtetëror çdo informacion lidhur me veprimet procedurale dhe ecurinë e procesit të ekzekutimit.

Neni 39

Marrëdhëniet me palën debitore dhe personin e tretë

1. Pala debitore, personat e barazuar me të ose personi i tretë detyrohet të lejojë përmbartuesin gjyqësor shtetëror të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për ekzekutimin e detyrueshëm, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

2. Debitori me fillimin e veprimeve procedurale, pas kërkesës së përmbauesit gjyqësor shtetëror, deklaron pasuritë e tij dhe saktësinë e të dhënave të tyre. Ndaj debitorit që fsheh, nuk jep apo i jep në mënyrë fiktive të dhënat mbi pasuritë e tij përmbauesit gjyqësor shtetëror, zbatohen sanksionet e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

3. Pala debitore, personat e barazuar me të ose personi i tretë ka të drejtë të kundërshtojë veprimet e përmbauesit gjyqësor shtetëror në gjykatë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 40

Përgjegjësitë ndaj palëve në proces ekzekutimi dhe të tretëve

Përmbauesi gjyqësor shtetëror, që kryen veprimtarinë përmbaimore në kundërshtim me ligjin, mban përgjegjësi vetjake për dëmin që u shkakton palëve në proces ekzekutimi, si dhe për dëmin ndaj të tretëve.

Neni 41

Marrëdhëniet me të tretët

1. Përmbauesi gjyqësor shtetëror ka të drejtë të kërkojë informacionin e nevojshëm për procedurat e ekzekutimit nga organet publike, entet publike ose nga personat juridikë dhe fizikë që zotërojnë informacionin përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Informacioni i kërkuar i jepet përmbauesit gjyqësor shtetëror brenda pesë ditëve pune nga marrja e kërkesës zyrtare dhe jo më vonë se dy ditë pune kur informacioni kërkohet nëpërmjet komunikimit me postë elektronike, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

3. Ndaj personave fizikë ose juridikë, që paraqesin pengesë gjatë procedurave të ekzekutimit ose fshehin, deklarojnë apo japin të dhëna të pasakta në lidhje me prona, të ardhura, të drejta mbi pasuritë e debitorit, të kërkuara nga përmbauesi gjyqësor shtetëror, kur këto veprime përbëjnë vepër penale në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal, përmbauesi gjyqësor shtetëror bën kallëzim penal.

4. Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë me objekt “Takim dhe kujdestari fëmijë”, përmbauesi gjyqësor shtetëror njofton njësinë për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe kërkon asistencën e një psikologu.

5. Të dhënat e marra në përputhje me këtë nen trajtohen në përputhje me detyrimin e konfidencialitetit dhe sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 42

Bashkëpunimi me organet e tjera

1. Përmbauesi gjyqësor shtetëror për kryerjen e detyrave të ngarkuara bashkëpunon me Policinë e Shtetit, policitë e tjera, Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, njësitë e qeverisjes vendore, si dhe prefektin e qarkut.

2. Organet publike janë të detyruara të mbështesin dhe ndihmojnë përmbauesin gjyqësor shtetëror sa herë që kërkohet ndihma e tyre, kur çmohet nga përmbauesi gjyqësor shtetëror se veprimet procedurale përmbaimore nuk mund të kryhen pa mbështetjen, ndihmën apo prezencën e tyre.

3. Rregulla të hollësishme për kriteret, procedurën dhe mënyrën e bashkëpunimit dhe mbështetjes së përmbauesve gjyqësorë shtetërorë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrave përgjegjës, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

KREU VIII

KOMANDIMI DHE TRANSFERIMI

Neni 43

Komandimi

1. Përmbauesi gjyqësor shtetëror mund të komandohet si inspektor në strukturën përgjegjëse për inspektimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbaimit për një periudhë jo më shumë se 1 (një) vit. Pas mbarimit të periudhës 1-vjeçare, përmbauesi gjyqësor shtetëror ka të drejtën e rikomandimit në pozicionin e inspektorit.

2. Komandimi bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Përmbaimit, pasi të ketë marrë pëlqimin e përmbauesit gjyqësor shtetëror.

3. Përvoja e përmbauesit gjyqësor shtetëror, të komanduar nga zyra përmbaimore vendore përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbaimit, llogaritet përvojë pune në profesion.

4. Përmbauesi gjyqësor shtetëror gjatë komandimit ka përgjegjësi disiplinore sipas përcaktimeve që zbatohen për nëpunësit e tjerë, që kanë të njëjtin pozicion në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbaimit.

5. Përmbauesi gjyqësor shtetëror i komanduar merr pagën më të lartë ndërmjet pagës së pozicionit të mëparshëm dhe atij në të cilin është komanduar, si dhe shtesë në masën 1% për çdo ditë pune.

6. Rregulla të hollësishme për procedurën e komandimit, sipas këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 44

Transferimi i përkohshëm

1. Përmbauesi gjyqësor shtetëror mund të transferohet përkohësisht në një zyrë tjetër përmbaimore për nevoja të punës dhe në interes të shërbimit përmbaimit gjyqësor shtetëror.

2. Transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet në zyrën përmbaimore vendore më të afërt me zyrën e përmbauesit gjyqësor shtetëror, jo më shumë se 2 herë në vit, me kohëzgjatje deri në 3 muaj secila. Në përfundim të periudhës së transferimit, përmbauesi gjyqësor shtetëror rikthehet në zyrën përmbaimore ku është emëruar.

3. Për nevoja të punës, përmbauesi gjyqësor shtetëror mund të transferohet në zyrën përmbaimore më të afërt me të për ekzekutimin e dosjeve përmbaimore të caktuara.

4. Transferimi në një zyrë tjetër përmbaimore, sipas pikave 1 dhe 3 të këtij neni, bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Përmbaimit.

5. Përmbauesi gjyqësor shtetëror mund të refuzojë transferimin, sipas pikës 1 të këtij neni, në rastin kur gjendja shëndetësore e tij, provuar me vërtetimin mjekësor përkatës, e bën transferimin e pamundur.

6. Rregulla të hollësishme për transferimin e përkohshëm, sipas këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 45

Transferimi i përhershëm

1. Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i përmbauesit gjyqësor në një zyrë tjetër përmbaimore vendore, në rastet e:

a) shmangies së konflikteve të vazhdueshme të interesit;

b) mbylljes ose ristrukturimit të zyrës përmbaimore, ku përmbauesi gjyqësor ushtron funksionin e tij.

2. Përmbauesi gjyqësor shtetëror mund të refuzojë transferimin në rastet kur:

a) gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;

b) zyra përmbaimore vendore ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i përmbauesit gjyqësor shtetëror. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përbën shkak për largim nga detyra.

3. Transferimi i përhershëm i përmbauesit gjyqësor shtetëror bëhet me urdhër të ministrit, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Përmbaimit.

4. Rregulla të hollësishme për transferimin e përhershëm, sipas këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU IX

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL I PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Neni 46

Parimet e vlerësimit

Vlerësimi etik dhe profesional bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) parimi i paanshmërisë, sipas së cilit procesi i vlerësimit nuk duhet të ndikojë apo të ndërhyjë në paanësinë e përmbarduesit gjyqësor shtetëror;
- b) parimi i meritokracisë, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë së përmbarduesit gjyqësor shtetëror bëhet duke i dhënë rëndësinë më të madhe vlerave profesionale dhe cilësisë në punë;
- c) parimi i efikasitetit, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë përmbardimore bëhet nëpërmjet një procesi në afate kohore të arsyeshme, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- ç) parimi i konfidencialitetit, sipas të cilit subjektet e ngarkuara me detyrën e vlerësimit janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të përmbarduesit gjyqësor shtetëror që vlerësohet, si dhe të dhënat personale, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 47

Qëllimi i vlerësimit të përmbarduesit gjyqësor shtetëror

Qëllimi i vlerësimit etik dhe profesional të përmbarduesve gjyqësorë shtetërorë është:

- a) të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme etikën dhe aftësitë profesionale të përmbarduesve;
- b) të vendosë standarde të qëndrueshme për cilësinë e veprimtarisë së përmbarduesve;
- c) të informojë Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbardimit në lidhje me nevojat për trajnim të përmbarduesve dhe për të lehtësuar planifikimin e trajnimit të tyre;
- ç) të identifikojë përmbarduesit që mund të kenë aftësi të veçanta profesionale për sistemin e përmbardimit gjyqësor;
- d) të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të punës së përmbarduesve.

Neni 48

Subjektet e vlerësimit

1. Të gjithë përmbarduesit gjyqësorë shtetërorë, përfshirë kryetarët e zyrave përmbardimore, i nënshtrohen vlerësimit etik dhe profesional në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj.
2. Kryetarët vlerësohen gjithashtu edhe për veprimtarinë e tyre si kryetar zyre përmbardimore.

Neni 49

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi kryhet sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) aftësisë profesionale të përmbarduesit;
- b) aftësisë organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të përmbarduesit;
- ç) aftësisë personale dhe angazhimit profesional.

Neni 50

Aftësitë profesionale të përmbarduesit

1. Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të përmbarduesit vlerësohet aftësia profesionale e tij në drejtim të njohurive profesionale, teorike dhe praktike në fushën e ekzekutimit të detyruar përmbardimor, njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare, shitjes së sendeve në ankand publik, si dhe konstatimit të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike sipas legjislacionit në fuqi.

2. Aspekti i njohurive, sipas pikës 1 të këtij neni, vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e përmbauesit për të ekzekutuar tituj ekzekutivë dhe për të kryer veprimtari dytësore, sipas përcaktimeve të këtij ligji, duke u bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të kryer aktet dhe veprimet procedurale në përputhje me legjislacionin për ekzekutimin e detyrueshëm, për të bashkëpunuar me institucionet shtetërore apo me çdo subjekt tjetër sikurse parashikohet nga ligji për kryerjen e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, aftësia për të shitur sendin në ankandin e parë, aftësia për kryerjen e veprimeve ligjore të nevojshme, si dhe për konstatimin e realitetit në procesverbalin e mbajtur për konstatimin e fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme.

Neni 51

Aftësitë organizative

1. Me anë të kriterit të aftësisë organizative vlerësohet aftësia e përmbauesit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat përmbaimore, si dhe aftësia për të administruar dosjet përmbaimore duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga përmbauesi dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit.

2. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo dosjeje, në rendimentin e përfundimit të çështjeve përmbaimore dhe kohën mesatare për ekzekutimin e detyrueshëm të një titulli ekzekutiv, kryerjen e njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare, shitjes së sendeve në ankand publik dhe konstatimit të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike sipas legjislacionit në fuqi.

3. Aftësia e përmbauesit për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat përmbaimore matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar për ekzekutimin e dosjeve përmbaimore.

4. Aftësia për të administruar dosjet përmbaimore matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes.

Neni 52

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

1. Me anë të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale vlerësohet aftësia e përmbauesit për etikën në punë dhe paanësinë.

2. Etika në punë e përmbauesit në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tilla si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, si dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore.

3. Paanësia e përmbauesit në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit matet duke u bazuar në tregues të tillë, si: numri i kërkesave për mospranimin e ekzekutimit dhe heqje dorë nga ekzekutimi i dosjeve përmbaimore që i janë ngarkuar.

Neni 53

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

1. Me anë të kriterit të aftësisë personale dhe angazhimit profesional vlerësohen aftësitë e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmëria për punë në grup, si dhe aftësia për t'u angazhuar në trajnime profesionale.

2. Aftësia e komunikimit të përmbauesit matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit të qartë dhe transparent me palët, subjektet e tjera, të tretët, në respektim edhe të parimit të konfidencialitetit. Vlerësimi i aftësive drejtuese si kryetar i zyrës përmbaimore me të paktën "shumë mirë" ka përparësi në vlerësimin si përmbaues, i cili kryhet pas vlerësimit si kryetar i zyrës përmbaimore.

3. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmëria në grup matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit dhe bashkëveprimin me kolegët apo stafin administrativ të zyrës përmbaimore, si dhe shkëmbimit të njohurive apo të përvojës profesionale me ta.

4. Gatishmëria për t'u angazhuar në trajnime profesionale matet duke u bazuar në tregues të tillë, si: pjesëmarrja e përmbaruesit në trajnimet vazhduese, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale dhe publikimet akademike.

Neni 54

Burimet e vlerësimit

Vlerësimi i përmbaruesve gjyqësorë bazohet në këto burime:

- a) të dhënat statistikore për veprimtarinë e ekzekutimit të titujve ekzekutivë;
- b) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj përmbaruesit;
- c) informacioni nga institucioni trajnues, që vërteton pjesëmarrjen dhe ecurinë e përmbaruesit në formimin vazhdues apo në veprimtaritë të tjera trajnuese;
- ç) vendimet përfundimtare për masat disiplinore, që janë dhënë ndaj përmbaruesit, dhe nëse masat disiplinore janë shuar ose jo;
- d) kundërshtimet e përmbaruesit;
- dh) mendimi i kryetarit të zyrës përmbarimore;
- e) qëndrimet e gjykatës lidhur me ankimet e palëve për kundërshtimin e veprimeve të kryera nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror;
- ë) raportet e inspektimit për veprimtarinë procedurale, administrative dhe financiare të përmbaruesit gjyqësor shtetëror;
- f) çdo të dhënë tjetër, që tregon aftësitë e kualifikimit profesional të përmbaruesit.

Neni 55

Nivelet e vlerësimit

1. Vlerësimi i përmbaruesit gjyqësor shtetëror kryhet, sipas këtyre niveleve:

- a) “Shkëlqyeshëm” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta;
- b) “Shumë mirë” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren;
- c) “Mirë” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare;
- ç) “Mjaftueshëm” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren;
- d) “I pamjaftueshëm” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët.

2. Vlerësimi i përgjithshëm “Shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur përmbaruesi është vlerësuar “Shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret.

3. Vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur përmbaruesi vlerësohet “Shumë mirë” për tri kriteret dhe “mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “Aftësitë profesionale” dhe “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” duhet të jenë vlerësuar “Shumë mirë”.

4. Vlerësimi i përgjithshëm “Mirë” jepet në rastin kur aftësitë e përmbaruesit vlerësohen “Mirë” për dy kriteret dhe “Mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “Mjaftueshëm” dhe “I pamjaftueshëm”.

5. Vlerësimi i përgjithshëm “I pamjaftueshëm” jepet në këto raste, kur:

- a) përmbaruesi vlerësohet “I pamjaftueshëm” për të paktën në tri kriteret;
- b) përmbaruesi vlerësohet “I pamjaftueshëm” për kriteret “Aftësitë profesionale” dhe “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe jo më shumë se “Mirë” për dy kriteret e tjera.

Neni 56

Kriteret për vlerësimin e veprimtarisë së kryetarit të zyrës përmbarimore

Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të një zyre përmbarimore kryhet bazuar në këto kriteret:

- a) aftësisë drejtuese dhe organizative;
- b) aftësisë së komunikimit.

Neni 57

Aftësitë drejtuese dhe organizative

1. Me anë të kriterit të aftësive drejtuese dhe organizative vlerësohen aftësitë e kryetarit të zyrës përbarimore për organizimin e qartë të veprimtarive administrative nëpërmjet dhënies së vendimeve dhe urdhrave për të siguruar respektimin e afateve dhe përdorimin sa më të mirë të burimeve të disponueshme, si dhe transparencën në zyrë.

2. Kriteri i aftësive drejtuese dhe organizative matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me mirorganizimin e punës dhe shpërndarjen e dosjeve përbarimore në raport të drejtë me ngarkesën e përbaruesve, komunikimin e prioritetëve, aftësinë për të përdorur me efektshmëri burimet financiare dhe njerëzore, zëvendësimin në kohë të përbaruesve, që kanë pengesa për kryerjen e procedurës së ekzekutimit, krijimit të ambienteve të përshtatshme në zyrë, në përputhje me nevojat e palëve dhe zhvillimin e mbledhjeve me përbaruesit.

3. Përfshirja e kryetarit të zyrës përbarimore në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit përbarimor ose në trajnime profesionale për drejtimin dhe organizimin e zyrave përbarimore vlerësohet me përparësi në matjen e këtij kriteri.

Neni 58

Aftësitë komunikuese

1. Me anë të kriterit të aftësisë komunikuese vlerësohet aftësia e kryetarit të zyrës përbarimore për komunikim të qartë, në kohë dhe transparent.

2. Ky kriter matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me bashkëpunimin efektiv dhe në kohë me Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Përbarimit, Këshillin e Përbarimit, njësitë e qeverisjes vendore, Policinë e Shtetit apo me çdo institucion ose subjekt tjetër, si dhe komunikimin me publikun dhe të tretët.

Neni 59

Burimet e vlerësimit për veprimtarinë e kryetarit të zyrës përbarimore

Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të zyrës përbarimore bazohet në këto burime:

- a) të dhëna statistikore për funksionimin e zyrës përbarimore në 5 (pesë) vjetët e fundit;
- b) vendimmarrjen e kryetarit të zyrës përbarimore në zbatim të kompetencave drejtuese dhe menaxheriale;
- c) raportet e inspektimit të zyrës përbarimore nga institucionet shtetërore;
- ç) çdo dokument, i cili tregon aftësitë e komunikimit të kryetarit të zyrës përbarimore me publikun dhe të tretët;
- d) të dhëna për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj kryetarit të zyrës përbarimore në këtë cilësi;
- dh) vendime përfundimtare për masa disiplinore për shkak të pozicionit të kryetarit të zyrës përbarimore, pavarësisht nëse masa disiplinore është shuar ose jo;
- e) kundërshtimet e kryetarit të zyrës përbarimore;
- ë) çdo burim tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të kryetarit të zyrës përbarimore.

Neni 60

Nivelet e vlerësimit

1. Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të zyrës përbarimore kryhet sipas këtyre niveleve:

- a) “Shumë mirë” në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mbi mesataren;
- b) “Mirë” në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mesatare;
- c) “Mjaftueshëm” në rastin e veprimtarisë drejtuese nën mesatare.

2. Vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” jepet nëse veprimtaria drejtuese e kryetarit të zyrës përbarimore vlerësohet “Shumë mirë” në të dyja kriteret. Vlerësimi i përgjithshëm “Mjaftueshëm” jepet nëse veprimtaria drejtuese e kryetarit të zyrës përbarimore vlerësohet “Mjaftueshëm” të paktën

në një prej kriterëve. Në rastet e tjera veprimtaria drejtuese e kryetarit të zyrës përbarimore vlerësohet “Mirë”.

Neni 61 **Periudha e vlerësimit**

1. Përbaruesi gjyqësor shtetëror vlerësohet 1 herë në 2 vjet gjatë 15 viteve të para të përvojës profesionale.
2. Përbaruesi gjyqësor shtetëror vlerësohet 1 herë në 5 vjet pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si përbarues gjyqësor shtetëror.
3. Kryetari i zyrës përbarimore vlerësohet të paktën 1 herë gjatë ushtrimit të detyrave si kryetar.

Neni 62 **Procedura e vlerësimit**

1. Këshilli i Përbarimit, jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti, miraton programin, që përcakton listën e përbaruesve dhe kryetarëve të zyrave përbarimore për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit pasardhës dhe periudhën e vlerësimit. Programi publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përbarimit.

2. Kryetarët e zyrave përbarimore dhe përbaruesit, të cilët do të vlerësohen sipas programit të miratuar, njoftohen në kohën e duhur nga Këshilli, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 javë nga momenti i vlerësimit sipas përcaktimeve të kësaj dispozite.

3. Përbaruesi kryen vlerësimin etik dhe profesional të tij sipas formularit standard të vendosur nga Këshilli i Përbarimit brenda 3 (tre) javëve nga marrja e njoftimit, nëpërmjet të cilit përbaruesi:

- a) vlerëson detyrat e ushtruara përkundrejt kriterëve vlerësues;
- b) paraqet një analizë të të dhënave statistikore që lidhen me veprimtarinë e tij si përbarues;
- c) përshkruan masat që ka ndërmarrë për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në vlerësimin e mëparshëm;
- ç) përshkruan shkallën, në të cilën janë përmbushur këto objektiva, duke dhënë edhe shpjegimin përkatës;
- d) përshkruan objektivat për zhvillimin e tij profesional për vlerësimin e ardhshëm të tij;
- dh) përshkruan nevojat për trajnim dhe, nëse ka, rrethanat të cilat përbëjnë pengesë për zhvillimin e tij profesional dhe propozon zgjidhje konkrete për periudhën e ardhshme të vlerësimit.

4. Përbaruesi dorëzon formularin e plotësuar pranë kryetarit të zyrës përbarimore.

5. Kryetari i zyrës përbarimore jep mendimin për veprimtarinë e përbaruesit në përputhje me standardet e vendosura nga Këshilli i Përbarimit brenda 10 ditëve nga dorëzimi i formularit. Në mendimin e kryetarit të zyrës përbarimore përshkruhet veprimtaria e përbaruesit gjyqësor dhe vlerësimi i tij për këtë veprimtari, sipas kriterëve të vlerësimit, duke u bazuar në nivelet e vlerësimit të parashikuara në këtë ligj. Gjithashtu, në mendimin e kryetarit të zyrës përbarimore pasqyrohet një analizë e të dhënave statistikore të veprimtarisë së përbaruesit.

6. Brenda tri ditëve nga njoftimi i mendimit të kryetarit të zyrës përbarimore, përbaruesi gëzon të drejtën për t'u dëgjuar dhe paraqet kërkesë për zhvillimin e një takimi me kryetarin e zyrës përbarimore.

7. Kryetari i zyrës përbarimore zhvillon takimin me përbaruesin brenda dy javëve nga data e depozitimit të kërkesës dhe merr masat për pasqyrimin e takimit në procesverbal, i cili i bashkëlidhet mendimit të kryetarit të zyrës përbarimore.

8. Jo më vonë se 5 ditë nga realizimi i takimit, kryetari i zyrës përbarimore i dërgon Këshillit të Përbarimit aktet e vlerësimit të përbaruesit, ku përfshihen vlerësimi i kryer nga përbaruesi, mendimi përfundimtar i kryetarit të zyrës përbarimore për veprimtarinë e përbaruesit, kundërshtitë e mundshme të përbaruesit ndaj mendimit të kryetarit të zyrës përbarimore dhe procesverbalin e dëgjësës. Nëse është e nevojshme për qëllime të vlerësimit, Këshilli i Përbarimit mund të kërkojë informacione shtesë nga kryetari i zyrës përbarimore apo përbaruesi gjyqësor shtetëror.

9. Brenda një muaji nga marrja e akteve të vlerësimit, sipas pikës 8 të këtij neni, Këshilli i Përmbartimit, pasi shqyrton dokumentacionin, merr vendimin për vlerësimin, të cilin ia njofton brenda 20 ditëve përmbartuesit dhe zyrës përmbartimore ku është i emëruar, Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe ministrit.

10. Në rastet kur përmbartuesi vlerësohet “I pamjaftueshëm”, i ulet paga me 2% gjatë dy viteve kalendarike pas këtij vlerësimi.

11. Përmbartuesi, kur nuk është dakord me vendimin e Këshillit të Përmbartimit për vlerësimin e tij, ka të drejtë ta ankmojë në gjykatën administrative kompetente, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

KREU X PEZULLIMI I PËRMBARTUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Neni 63

Pezullimi

1. Përmbartuesi gjyqësor shtetëror mund të pezullohet përkohësisht nga detyra nga ministri, kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;

b) ndaj tij ka filluar një procedurë për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar;

c) deklarohet i zhdukur me vendim të formës së prerë të gjykatës, deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim të formës së prerë të gjykatës;

ç) nëse ndodhet në gjendje konflikti interesi të vazhdueshëm, deri në transferimin e tij në një pozicion tjetër, sipas nenit 45 të këtij ligji;

d) nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga përmbartuesi gjyqësor shtetëror, ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij. Në këtë rast pezullimi vendoset deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

2. Kundër urdhrit të ministrit, përmbartuesi gjyqësor shtetëror mund të bëjë ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Neni 64

Efektet e pezullimit

1. Në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit, përveçse kur vendoset largimi nga detyra, sipas këtij ligji, përmbartuesi gjyqësor rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një zyrë tjetër përmbartimore sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

2. Periudha e pezullimit në rastet e parashikuara nga shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 63 të këtij ligji, llogaritet si vjetërsi pune në profesion.

3. Përmbartuesi gjyqësor shtetëror gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë. Në rastet e parashikuara nga shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 63 të këtij ligji, përmbartuesi përfiton 50% të pagës së plotë. Në rastin e parashikuar nga shkronja “a” e pikës 1 të nenit 63 të këtij ligji, kur vendoset pushimi i çështjes apo pafajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë, përmbartuesit gjyqësor shtetëror i jepet paga e plotë që nga momenti i pezullimit.

KREU XI PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 65

Fillimi i hetimit

1. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit vendos të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar ose të arkivojë një ankesë brenda 3 muajve nga marrja e ankesës.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur Këshillit të Përmbarrimit raportin e hetimit ose merr vendim për mbylljen e hetimit.

3. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit mund të zgjasë afatin e hetimit në raste komplekse për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit apo në rast sëmundjeje ose pamundësisë së përmbarruesit gjyqësor, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

4. Në rastet kur pas kalimit të afateve të parashikuara në pikat 2 ose 3 të këtij neni, dalin prova të reja, mbi bazën e të cilave ka shkaqe të arsyeshme të besohet se shkelja mund të ketë ndodhur, drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit riçel hetimin, me kushtin që të mos jetë parashkruar sipas nenit 85 të këtij ligji.

Neni 66

Ankesat

1. Çdo individ, person juridik ose zyrtar përmbarrimor vendore kanë të drejtë t'i paraqesin drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit ankesa të arsyetuara me shkrim.

2. Në rastet kur ka të dhëna të besueshme që përmbarruesi mund të ketë kryer shkelje disiplinore, çdo funksionar publik që ka dijeni duhet të informojë drejtorin e përgjithshëm të Përmbarrimit.

3. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit ka detyrimin të shqyrtojë të gjitha ankesat, përveç atyre anonime. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit.

4. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda 10 ditëve. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit i njofton ankuesit vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit përkatës.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarrimit informon ministrin mbi ankesën e paraqitur, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur faktet për të cilat kërkohet fillimi i procedimit disiplinor, shkeljen e pretenduar, si dhe vendimmarrjen përkatëse.

6. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës dhe mbylljen e hetimit të filluar nëse drejtori i Përgjithshëm i Përmbarrimit vlerëson që ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij.

7. Formulari i ankesës publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit.

Neni 67

Fillimi i hetimeve kryesisht

1. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit fillon hetimin me iniciativën e vet bazuar në të dhëna thelbësore dhe mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përfitohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit nxjerr vendim të arsyetuar për fillimin e hetimit kryesisht, duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme. Vendimi i njoftohet edhe përmbarruesit.

Neni 68

Bashkimi i hetimeve, shtimi dhe ndryshimi i objektit të hetimit

1. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se një shkelje tjetër mund të ketë ndodhur, drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit urdhëron shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit në zbatim të nenit 67 të këtij ligji dhe njofton ankuesin, përmbarruesin gjyqësor, Këshillin Përmbarrimor, si dhe ministrin.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit bashkon hetimet në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtat përmbarrues.

Neni 69

Pezullimi i hetimeve

1. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit urdhëron pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil, në të cilat:
 - a) njëra nga palët është përmbarruesi gjyqësor shtetëror;
 - b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte për të cilat do të merret vendimi.
2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent.
3. Ankuesi, përmbarruesi gjyqësor shtetëror, gjykata, prokuroria, zyra përmbarrimore, Këshilli i Përmbarrimit Disiplinor dhe ministria njoftohen me shkrim për urdhrin e pezullimit.
4. Gjykata, prokuroria ose institucione të tjera i dërgojnë drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit pa vonesë çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës.
5. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit u referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi gjyqësor i formës së prerë. Vendimi gjyqësor i formës së prerë në favor të përmbarruesit nuk pengon hetimin për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të përmbarruesit.
6. Pezullimi i hetimeve ndërpret afatin e parashkrimit të parashikuar nga neni 83 të këtij ligji.
7. Urdhri për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.

Neni 70

Të drejtat e përmbarruesit gjatë hetimit

1. Përmbarruesi gjyqësor shtetëror është palë në proces që nga momenti i fillimit të hetimit disiplinor dhe atij i garantohet aksesin në dosjen e hetimit në atë masë që nuk cenon sekretin e hetimit.
2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit mund të kërkojë nga përmbarruesi gjyqësor shtetëror informacione, dokumente ose çdo provë që është e nevojshme për hetimin.
3. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit i njofton përmbarruesit gjyqësor shtetëror ose përfaqësuesit të tij vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit.

Neni 71

Ecuria e hetimeve

1. Objekti i hetimit tregon qartë elementet e shkeljes së pretenduar, sipas përcaktimeve në vendimin për fillimin e hetimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.
2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit thërret dëshmitarë dhe mbledh të dhëna, dokumente dhe prova nga gjykata, prokuroria, institucione të tjera shtetërore, organizata, dëshmitarë, si dhe nga përmbarruesi dhe ndërmer veprime të nevojshme për të hetuar e përcaktuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur.

Neni 72

Kërkesat për marrjen në pyetje

1. Kur drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit vlerëson se marrja në pyetje e përmbarruesit, dëshmitarëve ose personave të tjerë paraqet rëndësi për hetimin, i njofton ata lidhur me kohën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje.
2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit merr masa për dokumentimin e seancës së marrjes në pyetje, sipas rregullave të parashikuara në këtë nen.
3. Regjistrimi audio i seancës së marrjes në pyetje përmbledhet në procesverbal dhe zbardhet me kërkesë të palëve. Përmbarruesi nënshkruan procesverbalin e marrjes në pyetje, si dhe transkriptimin e regjistrimit audio.
4. Regjistrimi audio, transkriptimi i tij, si dhe procesverbali i seancës së marrjes në pyetje bëhen pjesë e dosjes.

Kërkesat në lidhje me mbledhjen e provave nga institucionet e tjera

1. Çdo organ publik, person fizik ose juridik përmbush në kohë kërkesat e drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit për marrje informacioni, dokumente ose prova të tjera që lidhen me hetimin, brenda afateve kohore të arsyeshme të përcaktuara në kërkesë, me përjashtim të rasteve kur dhënia e tyre është e kufizuar me ligj.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit përsërit kërkesën në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk e përmbush atë brenda afatit të caktuar, duke informuar në rastin e personit juridik edhe drejtuesin e tij. Në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk përmbush kërkesën e përsëritur brenda afatit të caktuar, drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit njofton organin përgjegjës disiplinor.

3. Nëse gjatë hetimit disiplinor të përmbarruesit gjyqësor shtetëror ekziston nevoja thelbësore dhe specifike për të marrë dokumente, informacione, të cilat mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit mund t'i kërkojë gjykatës me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë lëshimin e një urdhri për dhënien e informacionit të kërkuar për përmbarruesin. Vendimi i gjykatës merret nga gjyqtari i vetëm në dhomë këshillimi brenda 15 ditëve nga dorëzimi i kërkesës.

4. Kërkesa duhet të përmbajë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se përmbarruesi gjyqësor shtetëror ka kryer shkeljen dhe se informacioni i kërkuar është thelbësor për të përcaktuar nëse shkelja ka ndodhur.

Dokumentacioni i hetimit

1. Struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit dokumenton çdo veprim hetimor me procesverbal.

2. Procesverbali përmban:

- a) emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës që kryen veprimin;
- b) datën e kryerjes së veprimit;
- c) subjektin dhe objektin e veprimit;
- ç) pjesëmarrësit;
- d) përshkrimin e hollësishëm të veprimit të kryer;
- dh) nënshkrimin e personave që marrin pjesë në këto veprime.

3. Me përfundimin e hetimit disiplinor, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit harton raportin e hetimit, i cili përmban të paktën:

- a) emrin dhe mbiemrin e hartuesve të raportit;
- b) shkaqet për të filluar hetimin, subjektin dhe objektin e hetimit, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin për fillimin e hetimit, ndryshimin ose shtimin e objektit të hetimit;
- c) veprimet e kryera gjatë hetimit;
- ç) përmbledhjen e deklaratave të përmbarruesit gjyqësor shtetëror përkatës dhe të personave të tjerë ose institucioneve;
- d) parashtrimin e fakteve të pranuar dhe të papranuara, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre;
- dh) analizën ligjore të fakteve të pranuar që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur;
- e) propozimin për mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore.

Përfundimi i hetimit

1. Në përfundim të hetimit, nëse ka dyshime të arsyeshme që përmbaruesi gjyqësor shtetëror ka kryer shkelje disiplinore, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit fillon procedimin disiplinor duke paraqitur në Këshillin e Përmbarimit raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit mbyll hetimin nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit, se:

a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;

b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë në kuadër të një procedimi disiplinor, përveç rasteve kur paraqiten fakte ose prova të reja;

c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi për shkak të kalimit të afateve;

ç) përmbaruesi ka ndërruar jetë.

3. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit i njofton vendimin përmbaruesit gjyqësor shtetëror të interesuar ose përfaqësuesit të tij, ankuesit, Këshillit Përmbarimor dhe ministrit. Vendimi përmban arsyet për mbylljen e hetimit sipas pikës 2, të këtij neni.

Neni 76

Ridërgimi i çështjes drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit

Nëse gjatë procedimit disiplinor, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit merr informacion se ka dyshime të arsyeshme që mund të jetë kryer një shkelje tjetër, atëherë:

a) i kërkon Këshillit të Përmbarimit të ndërpresë procedimin disiplinor, urdhëron shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda 1 muaji nga ndërprerja e procedimit; ose

b) i kërkon Këshillit të Përmbarimit që të shtojë ose të ndryshojë objektin e procedimit disiplinor, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme.

Neni 77

Procedura përpara Këshillit të Përmbarimit

1. Këshilli i Përmbarimit cakton një datë për seancën dëgjimore pas marrjes së dosjes nga drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit dhe njofton palët për zhvillimin e seancës, së paku 10 ditë përpara.

2. Këshilli i Përmbarimit merr parasysh të gjitha rrethanat që kanë lidhje me çështjen.

3. Këshilli i Përmbarimit verifikon dokumentacionin e dosjes personale të përmbaruesit gjyqësor, përvojën dhe rezultatet individuale në ushtrimin e detyrës, rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore, rëndësinë e saj, shkallën e fajësisë, shpeshhtësinë e kryerjes së shkeljes, qëndrimin e përmbaruesit gjyqësor ndaj shkeljes së kryer, pasojat e mundshme dhe të shkaktuara, si dhe çdo situatë të mundshme jashtë kontrollit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror.

4. Komisioni disiplinor mund të marrë dëshmi shtesë, duke përfshirë thirrjen e dëshmitarëve, si dhe të angazhojë ekspertë kur e konsideron të përshtatshme.

5. Nëse provat shtesë nuk mund të sigurohen, Këshilli i Përmbarimit mund të kërkojë nga drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit që të kryejë hetime të mëtejshme duke specifikuar elementet e munguara dhe periudhën kohore për të cilën kërkohet hetimi.

Neni 78

Mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore

1. Këshilli i Përmbarimit vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore, nëse:

a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi;

b) pas nisjes së procedimit, rezulton se çështja ka qenë objekt i një procedimi të mëparshëm;

c) përmbaruesi ka ndërruar jetë.

2. Këshilli i Përmbarrimit mbyll procedimin disiplinor, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim. Këshilli i Përmbarrimit njofton palët dhe ministrin për shkaqet e mbylljes së procedimit disiplinor.

Neni 79

Bashkimi i procedimeve disiplinore, ndryshimi dhe shtimi i objektit të procedimit disiplinor

1. Këshilli i Përmbarrimit, kur konstaton që procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit përmbarrues, mund të vendosë bashkimin e procedimeve.

2. Këshilli i Përmbarrimit, kur e çmon së çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit përmbarrues gjyqësor shtetëror, ka të drejtë:

a) të vendosë për pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetimi i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim; ose

b) pa pezulluar procedimin disiplinor, t'i kërkojë drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor në përputhje me këtë ligj, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit 30-ditor.

Neni 80

Të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procedimit disiplinor

1. Gjatë procedimit disiplinor, përmbarruesit gjyqësorë shtetërorë ose përfaqësuesit të tij i sigurohet akses në dosje në masën që nuk cenon:

- a) interesat ligjorë të palëve ose personat e tretë;
- b) qëllimin e procedimit disiplinor;
- c) funksionet e organit vendimmarrës.

2. Kur përmbarruesit gjyqësor shtetëror i njoftohet se ndaj tij ka filluar procedimi disiplinor, duhet që t'i bëhen të ditura të drejtat, si më poshtë:

- a) për të paraqitur një parashitje me shkrim në afatin e caktuar;
- b) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;
- c) për të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;
- ç) për të paraqitur dokumente;
- d) për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;
- dh) për t'u përfaqësuar sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Këshilli i Përmbarrimit mund t'i kërkojë përmbarruesit gjyqësor shtetëror të paraqesë të dhëna, dokumente ose çdo lloj prove, si dhe të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

4. Palët njoftohen për çdo vendim të komisionit disiplinor brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Neni 81

Pezullimi i procedimit disiplinor

Rregullat për pezullimin e hetimit disiplinor zbatohen për atë që është e mundur për pezullimin e procedimit disiplinor.

Neni 82

Vendimet e Këshillit të Përmbarrimit

1. Këshilli i Përmbarrimit merr vendim, në lidhje me:

- a) angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre;
- b) shtyrjen e seancave;
- c) pranueshmërinë e provave;
- ç) zgjidhjen e çështjes; dhe
- d) çdo çështje tjetër që vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes.

2. Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, si dhe masës disiplinore të propozuar nga drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit, Këshilli i Përmbarrimit vendos:

a) rrëzimin e kërkesës për procedim disiplinor për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore; ose

b) pranimin e kërkesës, marrjen e një ose më shumë masave disiplinore dhe njoftimin e vendimit Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe ministrisë.

3. Këshilli i Përmbarrimit jep vendim të arsyetuar me shkrim brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.

Neni 83

Ekzekutimi i vendimeve të Këshillit të Përmbarrimit

Ministri brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së vendimit të Këshillit të Përmbarrimit nxjerr urdhrin për zbatimin e masave disiplinore përkatëse në të cilin parashikon edhe modalitetet e zbatimit të tij, sipas vendimarrjes së Këshillit të Përmbarrimit.

Neni 84

E drejta e ankimit

Kundër vendimeve për dhënien e masave disiplinore sipas këtij ligji mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

KREU XII

SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 85

Shkeljet disiplinore

1. Shkelje nga përmbarruesi gjyqësor shtetëror konsiderohen veprimet dhe mosveprimet e mëposhtme:

a) shkelja e rregullave të parashikuara nga ky ligj, ligjet e tjera dhe aktet nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së përmbarruesit gjyqësor shtetëror;

b) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 7 ditë e më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja në përmbushjen e detyrave të institucionit ose për të drejtat dhe interesat ligjore të palëve në proces ekzekutimi;

c) mospërmbushja me faj e veprimeve përmbarrimore të parashikuara në ligj, që kanë cenuar të drejtat e palëve në proces ekzekutimi;

ç) konflikti i interesit në një procedurë ekzekutimi;

d) mospërmbushja në mënyrë të qëllimshme dhe të pajustificuar të detyrave, që i caktohen përmbarruesit gjyqësor shtetëror;

dh) shkelja e detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit, sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave që disponon si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së tij;

e) mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë përmbarrimore;

ë) pakujdesia në drejtim të mbajtjes dhe administrimit të dosjeve dhe dokumentacionit të krijuar për shkak të detyrës;

f) mosrespektimi i rregullave të etikës dhe standardeve profesionale në marrëdhënie me palët, subjektet e tjera të përfshirë në proces, kryetarin e zyrës përmbarrimore, kolegët, personelin dhe publikun;

g) refuzimi apo pengimi i strukturës përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit apo strukturave të tjera shtetërore për të ushtruar kontroll për veprimtarinë përmbarrimore, në përputhje me detyrat e tyre;

gj) shkelja e besimit të palëve në proces nëpërmjet kryerjes së veprimeve të padrejta ose të parregullta me njërën prej tyre ose me të tretë për të mos ekzekutuar apo vonuar ekzekutimin e titullit ekzekutiv;

h) ushtrimi i praktikave të ndaluara sipas përcaktimeve të këtij ligji;

i) pakujdesia në drejtim të mbajtjes së dosjeve përmbare dhe dokumentacionit tjetër;

j) tejkalimi i kompetencave të dhëna nga ligji;

k) trajtimi i pasurive dhe aseteve në kundërshtim me ligjin ose autorizimin e palëve;

l) punësimi në detyra të tjera publike, administrative ose mbikëqyrëse apo angazhimi në veprimtari, të cilat janë në kundërshtim me integritetin, paanësinë e përmbare dhe parimet e ushtrimit të funksionit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

ll) kryerja e transaksioneve të veta në emër të një personi tjetër ose të transaksioneve të një personi tjetër në emër të vet, qenia palë në transaksione për të cilat vepron edhe si përmbare gjyqësor shtetëror;

m) përfitimi në mënyrë të padrejtë apo të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat, qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të detyrës që ushtron ose si pasojë e përdorimit prej tij të pozicionit të përmbaresit gjyqësor shtetëror;

n) shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar për të dhënat e klasifikuara si të tilla sipas legjislacionit në fuqi;

nj) kryerja brenda ose jashtë orarit zyrtar të veprimeve që cenojnë figurën e përmbaresit gjyqësor shtetëror, Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaremit apo shërbimin përmbare në tërësi;

o) mospërbushja e detyrimit për të marrë pjesë në formimin vazhdues, pa arsye të përligjura;

p) dëmtimi i pronës shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pronës shtetërore.

2. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 5 (pesë) vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja.

Neni 86

Masat disiplinore

1. Për shkeljet disiplinore jepen masat disiplinore të mëposhtme:

a) vërejtje;

b) vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra;

c) ulje e pagës deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë se 1 vit;

ç) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;

d) largim nga detyra.

2. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni jepen me vendim të drejtorit të përgjithshëm të Përmbaremit, ndërsa masat e parashikuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni jepen me vendim të Këshillit të Përmbaremit.

Neni 87

Parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore

1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Këshilli i Përmbaremit bazohet në:

a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;

b) shkallën e fajësisë;

c) ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashuara.

2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer.

Neni 88

Shuarja e masave disiplinore

1. Masat disiplinore shuhën, me përjashtim të masës së parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 86 të këtij ligji, pas kalimit të këtyre afateve:

- a) 1 vit nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 86 të këtij ligji;
- b) 2 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 86 të këtij ligji;
- c) 3 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 86 të këtij ligji;
- ç) 5 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të nenit 86 të këtij ligji;

2. Deklarimi i shuarjes bëhet kryesisht apo me kërkesë, me vendim të drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit. Masa fshihet nga dosja e personelit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror dhe regjistri disiplinor që mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit.

KREU XIII PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN PËRMBARIMOR SHTETËROR

Neni 89 **Dorëheqja**

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin përmbarimor shtetëror nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim te kryetari i zyrës përmbarimore, duke vënë në dijeni drejtorin e përgjithshëm të Përmbarimit.

2. Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj.

3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar të nëpunësit dhe me miratimin e kryetarit të zyrës përmbarimore, dorëheqja i prodhon efektet përpara afatit 30-ditor nga njoftimi.

Neni 90 **Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin përmbarimor shtetëror për shkak të ligjit**

1. Marrëdhënia në shërbimin përmbarimor shtetëror përfundon për shkak të ligjit, kur:

- a) përmbaruesi gjyqësor shtetëror ndërron jetë apo kur merr formë të prerë vendimi gjyqësor për deklarimin e vdekjes së tij;
- b) përmbaruesi gjyqësor shtetëror humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
- c) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;
- ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;
- d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin përmbarimor shtetëror, për shkak të ligjit, konstatohet 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij nga kryetari i zyrës përmbarimore.

Neni 91 **Largimi nga funksioni i përmbaruesit gjyqësor shtetëror**

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror largohet nga detyra, në rastet kur:

- a) ka marrë masën disiplinore të largimit nga detyra sipas këtij ligji;
- b) për shkak të refuzimit të pajustificuar për të pranuar transferimin e përhershëm, sipas këtij ligji;
- c) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit, të deklaruar nga vetë ai dhe nëse transferimi në një pozicion tjetër nuk do të mënjanonte gjendjen e konfliktit të interesit;
- ç) jep dorëheqjen nga detyra;
- d) deklarohet i paafët për punë nga komisioni kompetent mjekësor sipas ligjit;
- dh) pas dy vlerësimeve të njëpasnjëshme “I pamjaftueshëm” të rezultateve në punë;
- e) në çdo rast tjetër që parashikohet nga ligji.

2. Largimi nga detyra, me përjashtim të rastit të parashikuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, konstatohet me urdhër të ministrit brenda 10 ditëve nga njohja e shkakut të largimit.

KREU XIV DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 92
Dispozita kalimtare

1. Procedurat e nisura ose në proces në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji përfundojnë sipas dispozitave të zbatueshme përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Ndaj përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë, që në ditën e hyrjes në fuqi nuk kanë përfunduar periudhën e provës, procedura për emërimin përfundimtar të tyre në detyrë përfundon sipas dispozitave të zbatueshme përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.
3. Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në detyrë vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
4. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor”, të ndryshuar, do të jenë në fuqi deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 93
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 12, pika 5; 29, pika 2, dhe 31, pika 2, të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 2; 12, pika 4; 17, pika 5; 19, pika 4; 22, pika 3; 28, pika 4; 30, pika 2; 31, pika 3; 32 pika 6; 35, pika 3; 36, 42, pika 3, 43, pika 6; 44, pika 6, dhe 45, pika 4, të këtij ligji.
3. Ngarkohet ministri dhe ministri përgjegjës për financat që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, pika 2; 34, pika 3, dhe 35, pika 2, të këtij ligji.

Neni 94
Shfuqizime

Ligji nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 95
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.2.2023.

Shpallur me dekretin nr. 32, datë 24.2.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.